



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”.

Konsultim publik : *Banoret e Nj. Administrative Rrethina, Pult, Shalë dhe Shosh*

Data : 22.10.2021

Ora : 13.00

Vendi: *Salla e restorantit tek market Api*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 42, nga të cilat 11 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesem 2022-2024 të bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës : *Zv. Kryetar i bashkisë z. Tonin Dedaj, Administrator i Nj. Administrative z. Erjon Selgjakaj , Kryetarja e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadia, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise se Bujqesise Alban Sekja, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj.Aulida Anamali, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.*

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv.Kryetari i bashkisë dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtruan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

+

I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. Z. Taulant Shabani, Shkolla e “Ismet Sali Bruçaj”, propozon:

- a. Përmirësimi i kushteve në shkollë nepermjet shtimit te ambienteve ne shkolle. Problematikat vazhdojne te jene te medha vazhdojme të punojmë me dy turne. Duhet që te kthet mësimi me nje turn .Mirembajtja e kesaj godine eshte realizuar nga bashkia por eshte

e nevojshme të ketë edhe 5 ambiente të tjera në mënyre që të gjithë nxenesit të jene komod dhe me mesim ne nje orar .(shkolla ka 4 klasa, 101 nxenes, arsimi parashkollor 25 nxenes).

2. Znj. Selmane Grepj, Drejtor Shkolle Shtoj i Ri, propozon:

- a. Permiresimi i kushteve ne shkolle nepermjet mirembajtjes se shkolles (lyerje, riparim orendish, izolim tarrace).
- b. Permiresimi i kushteve ne shkolle nepermjet shtimit te ambjenteve ne shkolle. Nevojiten 2 klasa te reja. Kemi pasur mesim me dy turne dhe duhet qe te eliminojme mesimin turne.
- c. Oborri eshte shume i vogel dhe i pamjaftueshem per nxenesit e shkolles. (Shkolla ka 127 nxënës)

3. Znj. Ermira Celiku, Drejtoreshë e Shkolles se Dobrac paraqiti këto prioritete:

- a. Permiresimi i kushteve ne shkolle nepermjet shtimit te ambjenteve ne shkolle te cilat jane te pamjaftueshme. Janë 8 klasa, duhet të shtohen të paktën 2 klasa.
- b. Te krijohet nje kabinet informatike.
- c. Kerkohet transparence per buxhetin, duke publikuar se sa eshte buxheti per cdo shkolle ne kete menyre edhe mesuesit mund ta monitorojne shpenzimet qe behen per shkollen e tyre.
- d. Rregjistrimi ne e-Albania nuk ka funksionuar duhet te zgjidhet problemi i rregjistrimit ne Shkolla.

4. Zv. Kryetari i Bashkisë: Ju kujtoj që fondi nuk ndahet në bazë shkollash as në bazë numer nxënësish. Fondi shkon aty ku kemi më nevojë për investim, dhe prandaj jemi ketu.

5. Z. Tereze Brigja, Drejtoreshë Shkolla Bardhaj dhe keshilltare ne Keshillin Bashkiak Shkoder propozoi:

- a. Ndertimin e nje palestre ne Shkollen 9-vjeçare ne Bardhaj. Perderisa kemi edukim fizik 3 herë në javë është e nevojshme një palestra.
- b. Per sa i përket kabinetit të informatikes është detyrë e drejtorive arsimore paisja me laboratore informatike , biologjie etj, materialet didaktike duhen plotesuar nga Ministria përkatëse
- c. Politikat ne arsim jan të mbrapshta, pse vazhdojme te merret nxenesi nga x Njesi administrative dhe te shkojë për shkollim në shkollat e qytetit. Secili fshat duhet të ketë shkollën e vet dhe nxënësi duhet të shkojë për shkollim aty ku banon.
- d. Pse duhen bërë investime në shkolla ku ka pak nxënës.Po të marrim shkollat në nënshkodër nuk ka nxënës, bëhet mesim një mesues me 4 - 5 nxënës. Nuk më duket e drejtë që të bëhet investimi në këto zona. Të bëhet investim në shkolla ku numri i nxënësve është shumë më i madh.

6. Zv. Kryetari i Bashkisë: Vleresoj maksimalisht punen tuaj në atë shkollë. Për sa i përket palestrës do të bëjmë çmos për ta realizuar.

7. **Z. Edmira Danaj**, edukatore Koshpti Dobrac, nënvizoi me prioritet:
 - a. Izolimin e tarraces se kopshtit ne Dobrac. Kopshti nuk ka uje qe nje muaj.
 - b. Ka mungese ambjentesh, jane 50 femije ne 3 grupe.
 - c. Kemi nevojë për një sanitare.

8. **Z. Fadil Hasa**, banor i fshatit Golem.
 - a. Jam dakord me atë që citoj znj.Brigja. Eshte problem numri i ulet i nxenesve ne shkollen e Golemit, edhe pse eshte bere investimi nga bashkia ne Shkolle dhe te gjithë ambjetet jane me kushte te mira.
 - b. Meqenese këtu në këtë takim ka edhe deputete, nese cenohen te drejtat e njeriut duhet qe deputetja te çoje zerin ne parlament per te arritur që te gjithë nxenesit të shkojnë në shkollën më pranë banesës së tij .

9. **Z. Hilmi Sadrina**, Banor Fshati Bleran, kerkoi: te ndertohet nje kopesht ne Bleran.

II: MENAXHIMI i MBETJEVE

1. **Znj. Briselda Kadija**: “E ndajme diskutimin, si eshte sherbimi ? a duhen shtuar kontinjerë ? si eshte frekuenca e pastrimit ?

2. **Znj. Xhuliana Lecaj**, Banor Fshati Golem kerkoi:
 - a. Rruga Fisnikeria ka prezence uji dhe mbetjesh ne menyre te vazhdueshme. Pastrimi behet shume rralle, nuk e dijme se ne cfare frekuencash realizohet qe te monitorojme a behet apo jo.

3. **Z. Zija Cinari, Banor Fshati Golem kerkoi**:
 - a. Janë vendosur konteinerët vend e pa vend në fshatin Golem. Pika e grumbullimit të mbetjeve e vendosur ne hyrje te varrezave duhet te menaxhohet me mire. Ka nevojë per kazane shtesë.

4. **Z. Tonin Vukaj, Kryetar Fshati Hot i Ri kerkoi**:
 - a. Duhet shtuar kontinjerët tek ujesjellesi ne Hot te Ri.
 - b. Duhet rregulluar frekuenca e terheqjes prane PGM te Shkolla pasi ka shpeshhere mbetje te paevaluara ne orar kur ka frekuentim nga nxenesit.

5. **Z. Agim Meti, Kryetar Fshati Guci e Re kerkoi**:
 - a. Per sa i përket pastrimit nga mbetjet problemi është edhe nga banorët. Problemi është me kontinjerët të cilët cdo ditë levizen nga vendi i caktuar.
 - b. Ka nevojë per nderrim kontinjerësh pasi jane të amortizuarEshte problem hedhja e mbetjeve inerte ne kontinjerë. Nevojitet ndergjegjsim i banoreve. .

- 6. Z. Besmir Selimi**, banor Fshati Bardhaj kerkoi:
 - a. Tek pika e grumbullimit të mbetjeve në f.Bardhaj nuk pastrohen mbetjet rregullisht dhe është krijuar nje venddepozitim i madh i mbetjeve ne breg te Kirit. (jane rreth 20 – 30 shtepi)

- 7. Z. Taulant Shabani**, Banor Guci e Re:
 - a. Qytetaret kërkojne të njihen me rregulloren dhe kriteret e vendosjes se pikave të grumbullimit të mbetjeve. Duhet te ndergjegjsohen banoret. Duhet te vendosen gjoba për shkelesit, deri tani nuk është penalizuar asnje shkelës.

- 8. Z. Ermir Qershija**, Banor Fshati Dobrac:
 - a. Duhet levizur pikat e grumbullimit të mbetjeve tek dera e Shkolles, se përben rrezik për nxënësit. Janë 3 kontinjerë ku depoziton i gjithë fshati aty. Duhet shtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe kontinjerë.

- 9. Z. Agron Sadiku**, NjA Rrethina:
 - a. Duhet shtuar pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe kontinjerë. Ka prezence inertesh ne territor dhe duhet bere ndergjegjsim me banoret.

- 10. Z.Olsi Vata** , banor Fshati Bardhaj:
 - a. Kerkojme shtese kontinjerësh ne kryqezim prane shkolles pasi akumulohen shum mbetje dhe të shtohet frekuenca.

- 11. Z. Dede Gjoni**, Grudë e Re:
 - a. Duhet bërë ndërgjegjësime me banorët. Pastrimi bëhet. Të mërren masa administrative (gjobë) për ndotësit.

- 12. Z. Lutfi Drini**, Banor Shtoj i Vjetër:
 - a. Duhet te ju falenderojme pasi cdo 2 – 3 ditë kemi pastrim të mbeturinave. Problematike mbetet fakti qe mbetjet na vijne nga qyteti, psh tek Hekurudha. Policia duhet te gjobise shkelësit apo të vendose kamera për ti zbuluar ata.

- 13. Z. Fadil Hasa**, banor Golem kerkoi:
 - a. Eshte problem vendosja e PGM, banoret nuk i dojne afer shtepive se evadimi nuk behet rregullisht. PGM tek Varrezat ka kazane te demtuar dhe duhen ndertuar mure rrethuese. Ka nevojë për sensibilizim për kompostim se nuk duhet te hidhen mbetje bujqesore ne kazane.

14. Z. Dritan Alija, NjA Rrethina, Dobrac kerkoi:

- a. Eshte problem numri i ulet i pikave te grumbullimit të mbetjeve. Pastrimit duhet bërë përditë.
- b. Të shtohen kontinjerë tek Semeteja dhe tek tregu.

15. Kryeplaku f. Bleran:

- a. Eshte problem numri i hedhja e inerteve ne Lumin Kir.

16. Z.Tereze Brigja:

- a. Eshte problem levizja e kazaneve nga qytetaret dhe duhet ndertuar pikat e grumbullimit të mbetjeve fikse qe te mos levizen nga qytetaret.
- b. Pikat e grumbullimit të mbetjeve te shkollave duhet të jene brenda territorit te shkollave dhe te sherbejne vetem për shkollat.

17. Z. Agron, Kryetar fshati Bardhaj:

- a. Eshte problem hedhja e inerteve ne Lumin Kir. Ka nevojë për sensibilizim për kompostim se nuk duhet te hidhen mbetje bujqesore ne kazane.

18. Z.Pjeter Vuksani, banor Guci e Re:

- a. Shtimin e kontinjerëve ne Guci te Re.

19. Z.Gjeke Smajli, Banor fshati Hot i Ri kerkoi:

- a. Ka nevojë për sensibilizim, nuk duhet te hidhen mbetje bujqesore ne kazane. Eshte problem hedhja e inerteve ne kanal in Hotit. Duhet te gjobiten shkelesit.

III: NDRICIMI RRUGOR

1. Z.Pjeter Vuksani, banor Guci e Re kerkoi:

- a. Nevojiten ndricues ne rrugen qendrore Guci e Re

2. Z. Zija Cinari, Banor Fshati Golem, kerkoi:

- a. Nevojiten ndricues ne rrugen qendrore f.Golem, ka shtylla por ska asnje ndricues.

3. Banoret e f. Guci te Re kërkojnë që në rrugën e re që është bërë të vendoset ndricimi, nuk e dim a është e parashikuar apo jo por e kemi këtë kërkesë .

4. Z. Agim Meti, Kryeplak Guci e Re. Te realizohet ndricimi per aty ku ka rruge te shtruara me asfalt.

5. Z. Lutfi Drini, Banor Grude e Re: Nevojiten ndricues ne rrugen Grude e Re

6. Z.Tereze Brigja,

- a. Te vendosen ndricues ne rrugen e Hotit te Ri pasi është shumë e nevojshme sepse ka pasur edhe aksidente me vdekje. U bënë shumë vite që ka perfunduar investimi por ndricim nuk ka.

7. Zv Kryetari – Është nje rrugë e bërë nga ARRSH. Në dijeni dhe për sa jam marrë une, rruga e Hotit nuk është marrë në dorëzim pasi investitori që ka realizu punimet nuk ja ka dorezu bashkise. Pjesa nëntokësore ka dëmtime dhe bashkia nuk mund ta marrë në ngarkim duke pasur probleme.

8. Znj.Greta Bardeli, Deputete.

Më nxiti ceshtja për rrugën e Hotit investuar nga ARRSH, duhet ndjekur kjo situatë pasi janë të gjitha parametrat e rruges por nuk ka ndricim.

Një dëm i operatorit ekonomik apo institucionit nuk duhet ta paguajne banoret kete situatë duke u zvarritur per nje ceshtje qe duhet ndrecur bashkerisht me cdo ent te perfshire ne kete investim. Unë jam e autorizuar edhe për tju drejtuar ARRSH për sa i përket këtij investimi dhe të marrim një përgjigje sa me të shpejt për të mos sorollatur banoret, por ti jepet nje pergjigje. Nëse procesi vijon të zvarritet ju lutem më paisni me informacionin e duhur në mënyrë që ti drejtohem institucioneve pergjegjese.

9. Banor i fshatit Bardhaj

- a. Për sa i përket ndricimit, kerkojmë 10 drita në f. Bardhaj nëse është e mundur.

10. Z. Agim Sadiku, banor Shtoj i Ri

- a. Te realizohet ndricimi tek dy rrugët e fshatit Shtoj i Ri.

11. Z. Gerald Hasa, Keshilltar Bashkiak Banor Fshati Golem, kerkoi:

- a. Nevojiten ndricues ne rrugen qëndrore të f.Golem, ka shtylla por ska asnje ndricues.

12. Z. Emiljano Pjetri, Banor Fshati Bleran kerkoi:

- a. Te ndricohen rrugët qe te cojne ne institucionet fetare dhe varrezat.
- b. Te nderrohen ndricuesit e amortizuar ne shtyllat ekzistuese ne f.Bleran.

IV: SHERBIMI i KULLIMIT

13. Kryetar i f. Dobrac, kerkoi:

- a. Zhbllokimin e kanalit kryesor tek rrethrotulimi tek 5 Heronjte

14. Z. Angjelin Prendi, fshati Hot i Ri, kerkoi:

- a. Nuk furnizohemi me ujë të pishëm,
- b. Të zhbllokohet kanali vadites te bllokuar nga hedhja e inerteve.

15. Z. Olsi Vata, banor Fshati Bardhaj Kooperative kerkoi:

- a. Te pastrohen kanalet kullese se jane te papastruara.
- b. Kanalet vaditëse i pastrojmë vetë.

16. Z. Alban Sekja – Për sa i përket kanaleve kulluese mjete i pastrimit ka ardhur në Shtoj – Shtoj te Vjeter - Shtoj te Ri – Golem etj, Zona e Rrethinave ka problem tek uji i vaditjes pasi kanalet do të pastrohen me rradhë. Drejtimi i jone kryesor është sistemimi i vaditjes. Mjeti për pastrimin e kanaleve është në funksion, dhe me rradhë do kalojë edhe në bardhaj etj.

17. Kryeplaku Bardhaj, Bleran

- a. Nuk fajesoj bashkine për kanalet kulluese e vaditese pasi kjo situatë është tesh sa vite që degradon nga avulliat qe jane ndërtuar dhe bllokojnë kanalet.

18. Z. Taulant Shabani, Banorë f.Guci e Re nënvizoi nevojën për:

- a. Zhblokimin e kanalit kryesor ne Guci te Re te bllokuar nga ndertimet pa leje. Te ngrihet nje grup pune nga bashkia/ perfaqësi banoresh per ti hequr ato.
- b. Punimet në kanale mos të bëhen të pjesshëm, por te plota pasi të pjesshme nuk shërbejne. Eshte ndërtuar një pjesë e kanalit në Guci të Re, por nuk është lidhur me kanal in në Shtoj të Ri, kështu që vazhdon përmytja në rast shirash.

19. Kryeplaku Shtoj i Ri kerkoi:

- a. Duhet pastruar kanalet e bllokuara nga rrethrotulli i 5 Heronjve – Vrakë dhe kanali i rrugës së Qershive
- b. Përpara 4 vitesh është bërë pastrimi i kanaleve vaditëse, dhe e dimë të gjithë se si kanë qënë më përpara. Kërkoj që të zgjerohet kanali, që furnizimi të bëhet në sasi më të mëdha.

20. Z. Alban Sekja, Drejtor i Drejtorise ë Bujqësisë. Zona është shumë problematike per vaditjen, zona është shumë e vështire edhe nga mungesa e puseve në zone të cilet kan përherë probleme. Gjurmët e kanaleve në disa zona nuk ekzistojnë fare, kjo jo vetem ne rrethina por kudo në Shkodër. Ne kemi filluar diskutimet për një tarifë, të caktuar prej 2000 lekë për cdo hektar, dhe me këto të ardhura që do mbledhim do të investohen për plotesim të lidhjeve të kanaleve sipas mbledhjes së fondeve, pra vetem per siperfaqet qe mbulohen me vaditje do të ketë tarifë. Investimi i këtyre kanaleve është shumë i veshtirë për tu realizuar me të ardhurat tona.

21. Qytetari. Per sa i përket tarifës 20 mijë lekë për hektar, mendoj që ne e paguajmë këtë tarifë.

22. Z. Lekë Vukaj, Kryeplak Hot i Ri:

- a. Problem është ndërtimi i avullive, ku tashme është shumë e vështirë të sistemohen, pasi banoret e kanë pronë të tyre tashme.

- 23. Znj.B. Kadija** – edhe drejtor z.Alban e tha që investimet janë me kosto shumë të mëdha dhe një formë e mire është vendosja e një tarife të përbashkët për të formalizuar edhe pagesat edhe investimet.
- 24. Znj. Xhuliana Lecaj**, banore fshatit Golem: Kanalet e fshatit Golem janë të gjitha të bllokuara dhe duhet të pastrohen.

Banor i fshatit Grudë: Ne kemi problem në qendër të Grudës pasi uji shkon në 50 cm sa herë që bien rreshje , nqs mundeni të shikohet mundësia e ndërhyrjes.

- 25. Z. Gerald Hasa**, keshillar bashkiak dhe banor i Fshatit Golem kerkoi:
- a. Te pastrohen kanali qe sjell ujin nga Rezervuari i Shtodrit pasi eshte i bllokuar ne shume vende dhe kjo sjell permbytje ne shume zona. Ne kete kanal duhet bere disiplinim pasi ka shume nderhyrje nga individ dhe lidhje me kanale te tjera ekzistuese.
- 26. Banor i f. Bleran:**
- a. Kërkojmë që të pastrohen kanalet në Bleran pasi eshte problem kullimi i ujit anash rrugeve.

V: RRJETI RRUGOR RURAL

1. Për të gjithë pjesemarresit u shpërndanë flete vlerësimi për të listuar prioritetet për investime në rrugët që duhet të riparohen, rehabilitohen. Propozimet janë listuar më poshtë.
 - a. 1.Rr.Varrezave
 - b. 2.Rr.Prekal-Kir-Shosh-Breg Lumi
 - c. 3.Rr.Fisnikëria
 - d. 4.Rr.Hot i Ri
 - e. 5.Rr.Fusha e Aviacionit
 - f. 6.Rr.Guci e Re
 - g. 7.Rr.Hysaj
 - h. 8.Rr.Golem-Doganë
 - i. 9.Rr.Sektorit
 - j. 10.Rr.Mbarësia
 - k. 11.Rr.Haxhi Zeneli
 - l. 12.Rr.Dragoçit
 - m. 13.Rr.Trojej
 - n. 14.Rr.Skenderaj
 - o. 15.Rr.Haxhicaf
 - p. 16. Rr. Nga Shkolla Guci e re deri tek Lumi Vrakë
 - q. 17. Rr. Isaj
 - r. 18.Të asfaltohet rruga Hamidije Loti 2

- s. 19. Të asfaltohet rruga Guskiq
 - t. Mirëmbajtje e segmentit nga Gruda e Re deri tek shkolla Guci e re
 - u. 21. Shtrim Rr. Nga Shkolla Guci e re deri tek Lumi Vrakë
- 2. Z. Tom Marku**, administratori i Pultit kërkoi:
- a. Rehabilitimin e rrugës së Dukagjinit, sepse është vazhdimisht e bllokuar dhe në gjëndje të keqe në dimër. U sherben 3000 banoreve. Projekti i ri rruges së Dukagjinit anashkalon Pultin, duhet riparë.

VI. PYJET

- 1. Znj. Tereze Brigja**, Keshilltare Bashkiake dhe **Z. Tom Marku** administrator kerkuan:
- a. Ti kushtohet kujdes mbrojtjes së masivit pyjor në Dukagjin se po demtohet nga grereza e zezë kineze.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija.









BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024

Nj. Administrative Fierthina, Pult, Shalë dhe Shosh

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Olsi	Voto	M	32	Bardhaj		Ndërtim
2	Habib	Selma	M	36	Golem		Mentor
3	Harid	Plano	M		B. Shkodër	Udhë	P. Shkodër
4	Gerard	Nika	M	58	Sakocor	Udhë	Micelent
5	Sander	Lebiba	M	35	Crumbor	K/ç	R. Shkodër
6	Enes	Ruhos	M		Polezon	Udhë	
7	Gerard	HESAJ	M	27	Golem	MËDËTOR, MËDËSI	ADZM. I
8	Faustant	Shehmani	M	38	Buer e Re	Drejtores	Drejtor Socialë
9	Ermon	Arnelija	M	32	Sobras		
10	Driton	Alija	M	53	Dobras	K. Fshatit	As. Përcaktim
11	Emira	Dana	F	43	Shkodër	Edukatore	
12	Emira	Celiku	F	48	Shkodër	Drejtores	Drejtores Shkolle
13	Azire Bukaj	Bukaj	F	38	Golem	Edukatore	Edukatore

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024

Nj. Administrative Rrethina, Pult, Shtatë dhe Shosh

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Ritim	Bulhaj	M	48	Golem	Mesues	Shëfitor.
15	Elvin	Bojta	M	47	Shkodër	Jurat	RAF
16	Valbona	Dorica	F	34	Dobros	Mesuese	Papunë
17	Armelida	Mika	F	40	Skenderbop	Mesuese	re punesuar.
18	Agrom	Sadiku	M	50	SHTOJIRE	MONITORUS	PUNASUM
19	Agim	Meh	M	50	Guciale	—	—
20	Behm	Halili	M	56	Golem	Biznesmen	epunësuar
21	Elvira Hojja	Hoja	M	50	Golem	i punësuar	—
22	Arta Daku	—	M	58	SHTOJIRE	Dinje	Kryeshef
23	Arta	Nika	M	58	SHKODËR.	Spëcio list	Beullus Shkodër.
24	WIKOLIN	MOURASHI					
25	TEREZE FARISJA		F	59	HOTIRI	MESUES	Dr. SHKOLLE
26	Arta	PRULLI	M	62	LOTI	BULEZ	Arta

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024

Nj. Administrative Rrethina, Pult, Shalë dhe Shosh

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
27	Dede	Gjoni	M	51	Grudene	Punëtor	
28	Gjon	Gjoni	M	52	Hot, Ri	Teknik	Boguti
29	Elvis	Medina	M	42	Bleron	Teknik	-
30	Emiljano	Petri	M	33	Bleron	Pedagog	USA
31	Kristjan	Gjoni	M	30	Bleron	Udhëheqës	Boshti
32	Angjelinus	Udaci	F	57	Bleron	Qumësuese	Boshti
33	Adite	Zanoj	F	51	Hot, Ri	Domtore	Boshti
34	Muhant	Zanoj	M	60	Dobriç	Punëtor	jo
35	Gjyljana	Vesaj	F	45	Golem	e papunë	jo
36	Elinda	Deda	F	33	Golem	e papunë	jo
37	Caetim	Plepi	M	54	Dobriç	i punësuar	Topogruft
38	Gentian	Plepi	M	32	Dobriç	Topogruft	i punësuar
39	Fadi	Hasa	M	56	Golem		i papunë

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

